



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	<u>Menaxherin e prokurimit</u> Korporata Energjetike e Kosoves sh.a	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Safije Saramanti – Ekspert shqyrtues i prokurimit Lavdim Fejza - Ekspert Teknik		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues-teknik, lidhur me ankesën me Nr.343/19 parashtruara nga OE “Sodex Group” shpk		
Datë	04.07.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e dt. 26.06.2019 nga OE **Sodex Group” shpk** –Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit **Furnizim me instrumente metalprerese Lot 2** me nr.të prok:19-111-1-2-1 Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosoves sh.a AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosoves sh.a
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- **Sodex Group” shpk** - Prishtinë

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE **Sodex Group” shpk** - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me instrumente metalprerese LOT 2 me nr. të prokurimit: 19-111-1-2-1 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosoves sh.a



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		03.07.2019	04.07.2019
<i>Nënshkrimi i ekspertit</i>		<i>data e autorizimit të ekspertit.</i>	<i>data e dorëzimit të raportit</i>

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

1) Me date 26.06.2019, me nr. 343/19 të parashtruar nga **Sodex Group** shpk- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me instrumente metalprerese Lot 2 me nr. të prokurimit: 19-111-1-2-1 Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosoves sh.a

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues-teknik lidhur me këtë kërkesë, të veprojë. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues-teknik i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Operatori Ekonomik Ankues - Sodex Group” shpk- Prishtinë

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues **Sodex Group” shpk- Prishtinë** janë:

- Neni 1 - LPP-së
- Neni 6 - LPP-së
- Neni 7 - LPP-së
- Neni 56.3 - LPP-së
- Neni 59 - LPP-së
- Neni 60 - LPP-së
- Neni 72 - LPP-së

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE **Sodex Group” shpk - Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me instrumente metalprerese LOT 2 me nr. të prokurimit: 19-111-1-2-1 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosoves sh.a

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë:	18.01.2019
Lloji i procedurës së aplikuar:.....	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:.....	Kontratë publike furnizim, Blerje
Vlera e parashikuar e kontratës LOT 2:.....	25.000,00 €
Kriteri për dhënie të kontratës(N.52).....	Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.....	13.02.2019
Data e hapjes së ofertave.....	13.02.2019
Njoftimi mbi vendimin e AK	11.06.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim.....	20.06.2019
Data e vendimit lidhur me kërkesën për rishqyrtim pranë OSHP-se	26.06.2019

Kriteret për vlerësim:

III.2.1 Kërkesat e përshtatshmërisë:

11. Operatori ekonomik duhet të përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04/L-042 Neni 65.

2.Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk

është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohet vetëm për fituesin e tenderit.

3.Një dokument lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush “Kërkesat e përshtatshmërisë” Pika III.1.1.) 2.a,c,d dhe e. – origjinal ose kopje e noterizuar .-kërkohet vetëm për fituesin e tenderit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1.Një deklaratë nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit.

Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë, pika 2, dhe 3 do të kërkojnë nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t’ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit të këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE **Sodex Group** shpk - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me instrumente metalprerese LOT 2 me nr. të prokurimit: 19-111-1-2-1 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosoves sh.a

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

- 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
- 2.Regjistrimi i TVSH; ne vendin e themelimit
- 3.Regjistrimi i numrit fiskal

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- 1.Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend /Kopja e certifikatës së biznesit);
- 2.Kopja e certifikatës TVSH-se;
- 3.Kopja e certifikatës numrit fiskal

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Dëshmia e kërkuar dokumentare

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesiona:

- 1.Certifikatë të produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet
- 2.Katalogë apo prezantime grafike dhe/ose fotografi të produkteve për furnizim , bashkangjitur përshkrimit teknike detale për artikujt qe ofertoni

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- 1.Certifikata (Certifikimi i prodhuesit sipas ISO 9001)për të dy lotet.
- 2.Dokumentacioni autentik i prodhuesit si: katalogë/pjese te katalogut nga prodhuesi për të gjithë artikujt e dy loteve(pos art. 15 te lot.2) me përshkrime teknike detale për te gjithë artikujt e të dy loteve qe ofertoni. Ne katalog/pjese te katalogut sipas specifikimeve teknike te kërkuara te nënvizohen artikujt për pozicionet e kërkuara

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatorët Ekonomik	Vendi	Çmimi €	Vërejtje
1.	N.T.P “B&L”	Prishtinë	26.956,84	
2.	“Sodex Group” sh.p.k	Prishtinë	15.994,14	
3.	Union L.L.C	Prishtinë	24.449,60	

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Mehdi Sokoli - Kryetar i komisionit
- Shaban Ramadani - Anëtar i komisionit
- Lirak Ahmeti - Anëtar i komisionit

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesen e parashtruar nga **OE Sodex Group” shpk - Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me instrumente metalprerese LOT 2 me nr. të prokurimit: 19-111-1-2-1 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosoves sh.a

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po



Jo



Kërkesa për rishqyrtim është bërë me dt:17.06.2019, ndërsa vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim është pranuar me dt:20.06.2019

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 56.3 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së

**** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar, fillimisht ju rikujtojmë se ne, edhe herën e parë jemi eliminuar nga autoriteti kontraktues me arsyetimin se nuk e kemi llogaritur TVSH në çmimin e ofruar, ndërsa rikujtojmë se kërkesë e autoritetit kontraktues në FDT, konkretisht tek neni 5.4, ka qenë e parashtruar në këtë mënyrë, citojmë:

“...Për këtë aktivitet të prokurimit, për mallërat e importuara do të zbatohet Ligji Nr. 04/L-163, vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr 14/07 i datës 06.10.2017 dhe nr.08/40 i datës 11.04.2018 ku me rastin e importimit autoriteti kontraktues lirohet nga pagesa e doganës. Ky lirim doganor bazohet në vendimin nr. ILP TVSH 555/2018 i datës 27.07.2018 për lirim nga pagesa e TVSH, lënda e pare që shfrytëzohet për procesin e prodhimit i lëshuar nga Administrata tatimore e Kosovës për autoritetin kontraktues -Korporata Energjetike e Kosovës.”...

Duke u bazuar në kërkesën e lartpërmendur, ne kemi vepruar në këtë mënyrë, pasi që çdo kërkesë e

vendosur në FDT është kërkesë obligative, e të cilat duhet të plotësohen nga operatorët ekonomik pjesëmarrës, dhe njëkohësisht edhe AK duhet të bazohet në këto kërkesa gjatë vlerësimit të tenderëve.

Duke pasur parasysh faktin se pajisjet me të cilat kemi ofertuar ne, janë për përdorim të makinerisë prodhuese, janë prodhime të BE-së dhe do të duhej të importohen nga BE, të njëjtat do të duhej të liroheshin nga detyrimi i pagesës së TVSH-së në import. Këtë fakt madje edhe AK-ja, e ka përcaktuar si kërkesë obligative në pikën 5.4 madje ka potencuar saktë edhe faktin se posedon lirin doganor me vendimin ILP TVSH 555/2018 për këtë aktivitetet të prokurimit (siç përshkruhet në pikën 5.4 në FDT), oferta e jonë është kalkuluar dhe dorëzuar me TVSH Zero përqind, kurse autoriteti kontraktues është dashur të ketë parasysh që në rastet kur ne mund të jemi përfitues i kontratës dhe importojmë në cmër të KEK-ut, gjatë procedurës së zhdoganimit nga ne kërkohet që të prezantojmë në doganë kontratën e noterizuar dhe autorizimin e KEK-ut (të cilat do të duhej ti pranoheshin nga AK-ja pas nënshkrimit të kontratës) dhe të kërkojmë për pjesët e importuara të përdoret formulari LPR (lirim i pjesëve rezervë), sepse Korporata Energjetike e Kosovës sh.a, bazuar në autorizimin ILP TVSH të lëshuar nga ATK, bënë pjesë në listën e kompanive prodhuese dhe si e tillë lirohet nga detyrimet doganore, dhe veçanërisht TVSH-së, për çdo import të pjesëve rezervë, teknologjisë informative dhe linjave të prodhimit.

Duke u bazuar në kërkesat e FDT-së, që u cekën më lartë si dhe duke u bazuar në të gjitha dëshmitë, rezulton se ne ishim eliminuar për një kërkesë e cila nuk ka qenë e vendosur në dosje të tenderit, prandaj autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së ku parashihet si në vijim *“Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociatë, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.”*

Megjithatë, edhe nëse duhet të paguhet TVSH-ja, përsëri nuk ka asnjë problem ligjor dhe në këtë rast ne nuk mund të eliminohemi për këtë arsye sepse, edhe interpretimi i KRPP-së tek pyetje të shpeshta, pyetja me Nr. 46, është e sqaruar si në vijim, citojmë:

“...Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-së pa pasur nevojë të kërkojë sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë”...

Pra, edhe nëse supozojmë se duhet të përfshihet TVSH, atëherë autoriteti kontraktues është dashur ta kalkulojë dhe ta llogaritë TVSH-në, siç është e rregulluar me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës, për sa i përket importimit të pjesëve rezervë, teknologjisë informative dhe linjave të prodhimit.

Lidhur me ankesën tonë të parë është marrë një vendim nga OSHP, me nr.167/19 i dt:21.05.2019, ku na është aprovuar ankesa pjesërisht si e bazuar dhe aktiviteti i prokurimit është kthyer në rivlerësim.

Pas rivlerësimit të ofertave autoriteti kontraktues na ka eliminuar përsëri, por me arsyetimin: citojmë:

“Në ofertën tuaj të Formulari për dorëzimin e tenderit – Pjesa I. Formulari i tenderit dhe pjesa II. Përshkrimi i çmimit, nuk e keni paraqitur apo kalkuluar TVSH-në. AK ka vepruar konform vendimit të OSHP-së nr. 167/19 duke e llogaritur TVSH-në vlerës totale të ofertës tuaj. Vlera totale e ofertës tuaj është 15.994,14 €, pasi e kemi llogaritur normën e TVSH-së, vlera totale e ofertës suaj del të jetë 18.873,08 € atëherë vlera e ofertës tuaj është në kundërshtim me LPP-në, pasi që do kalon vlerën e 2% të lejuar për gabime aritmetikore sipas nenit 59.3 të LPP-së dhe për këtë arsye oferta juaj refuzohet”.

Sa i përket kësaj arsye të eliminimit dhe referimit në vendimin e OSIIP-së Nr.167/19, ju sqarojmë se me asnjë dispozitë të LPP-së, nuk shkruan se TVSH duhet të llogaritet dhe të përfshihet në gabime aritmetikore. Edhe vendimin e OSHP-së ne si OE e konsiderojmë se është një lëshim teknik në formulim të fjalisë, pasi që ka shumë vendime të OSHP-së, ku TVSH-ja është llogaritur apo është shtuar apo zbritur pa u konsideruar gabim aritmetikor, prandaj arsyeja e autoritetit kontraktues me rastin e eliminimit tonë është e pabazë dhe nuk ka asnjë mbështetje ligjore.

Poashtu në vendim shkruan se autoriteti kontraktues mund të llogarit TVSH sipas legjislacionit në fuqi, ndërsa referimi tek neni 59.3 i LPP-së me siguri është lëshim teknik sepse aty nuk flitet për TVSH, por vetëm për gabime aritmetikore.

Në vendimin e dt:20.06.2019 për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, autoriteti kontraktues përsëri i referohet vendimit të OSHP-së Nr.167/19, mirëpo ne ju sqarojmë se autoriteti kontraktues edhe gjatë rivlerësimit të ofertave i është shmangur çështjes kryesore-pra kërkesës obligative të vendosur në pikën 5.4 të FDT-së, ku shkruan qartë *"Për këtë aktivitet të prokurimit, për mallërat e importuara do të zbatohet Ligji Nr. 04/L-163, vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr 14/07 i datës 06.10.2017 dhe nr.08/40 i datës 11.04.2018 ku me rastin e importimit autoriteti kontraktues lirohet nga pagesa e doganës. Ky lirim doganor bazohet në vendimin nr. ILP TVSH 555/2018 i datës 27.07.2018 për lirim nga pagesa e TVSH, lënda e pare që shfrytëzohet për procesin e prodhimit i lëshuar nga Administrata tatimore e Kosovës për autoritetin kontraktues - Korporata Energjetike e Kosovës."*

Autoriteti kontraktues nuk është marr fare dhe nuk e ka zbatuar kërkesën e lartpërmendur të vendosur nga vetë ata, por ka bërë shmangie nga ajo kërkesë dhe kalon tek çështja e gabimeve aritmetikore, nëse janë apo jo mbi 2 % gabime aritmetikore, pas llogaritjes së TVSH-së.

Përfundimisht ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së edhe pas rivlerësimit, dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, sipas nenit 60 të LPP-së.

Po ashtu rezulton se edhe neni 1 nuk është respektuar, sepse dihet që qëllimi i LPP-së është të sigurohet mënyra më efikase, më transparente dhe më e drejtë e shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha faktet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET ankesa si e bazuar e OE "Sodex"-Prishtinë

ANULOHET njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës për Lot 2 dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM**.

Gjithashtu kërkojmë nga OSHP-ja që ta detyrojë autoritetin kontraktues, që rivlerësimi i ofertave të bëhet konform dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë sepse ne si kompani i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe duhet të shpallemi fitues të këtij tenderi, sepse jemi të përgjegjshëm dhe jemi me çmim më të ulët se ofertuesit tjerë, përndryshe ne do të detyrohemi të vazhdojmë me procedurat ligjore edhe në instancat tjera më të larta.

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni i vlerësimit pas Ekzaminimit, Vlerësimit dhe Krahimit të Tenderëve si dhe duke u bazuar edhe në vendimin e OSHP-së 167/19 për aktivitetin e prokurimit KEKO-19-030-121, "Furnizim me instrumente metalprerëse" LOT.2- Furnizim me përshpues qendror, burgia spirale, zgjerues makine, filetues, freza dykrahësh dhe dorëza për kalizvar ku ja llogaritur TVSH-ne vleres totale te ofertes se OE. Vlera totale e ofertes se OE eshte 15.994,14, pas pasi ja kemi llogaritur normen e TVSH-se, vlera totale e ofertes se OE del te jete 18.873,08 atëherë vlera e ofertës se OE eshte ne kundërshtim me LPP-në, pasi që do të kalon vlerën e 2% të lejuar për gabime aritmetikore sipas nenit 59.3 te LPP-se dhe për këtë arsye oferta e OE refuzohet.

Ndërsa sa i përket qeshtjes se a lirohen nga pagesa e doganes keto mallra, duke pas parasysh që OE importon në emër të KEK-ut gjatë procedurës së zhdoganimit nga OE kërkohet që të prezantohet në doganë kontratën e noterizuar dhe autorizimin e KEK-ut (te cilat pranohen nga AK pas nënshkrimit të kontratës) dhe të kërkohet për pjesët të importuara të përdoret formulari LPR (lirim i pjesëve rezervë).

Operatorët ekonomik që ofertojnë në tenderët që publikohen nga Korporata energjetike e Kosovës duhet të përfshijnë në çmim doganën bazuar në Tarifën e Integruar të Kosovës 2019 si dhe TVSH-ën, pra në këtë fazë nuk mund të sqarohet qeshtja e doganes për shkak se kërkesa të tilla parashtrihen në doganë me rastin e importimit të produkteve në Kosovë.

Komisioni i vlerësimit konsideron se oferta e OE UNION L.L.C i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë dhe si e tillë është oferta e përgjegjshme që ka ofruar çmimin më të lirë.

Komisioni i vlerësimit deklaron se aktiviteti i prokurimit është udhëhequr duke respektuar dispozitat e LPP-së Nr. 04/L-042 Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik dhe rekomandon që oferta e OE UNION L.L.C të shpërblehet me kontratë për këtë tender.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues

Përgjigje në Pretendimet ankimore : Sodex Group" shpk- Prishtinë

Eksperti shqyrtues / teknik sqarone se AK me rastin e rivlerimit të ofertave e ka cilesuar gabim aritmetik mos vendosjen e TVSH, pra AK e ka cilesuar përqindjen e tvsh si gabim aritmetik dhe që njëherë sipas AK –se bjen në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 LPP-se .

Eksperti shqyrtues vlerëson se nuk qëndron arsyetimi i AK –KeK se kemi të bëjmë me gabim aritmetik sepse një situatë e tillë është e sqaruar në pyetje/përgjigje nr.46 të publikuar në Webfaqen e KRPP-se , në të cilën thuhet :

46. Si të veprohet në rastet kur një Operator Ekonomik normën e TVSH-ës të përcaktuar me ligjin mbi TVSH-ën, për një apo më shumë artikuj në ofertën e tij e vendos gabimisht pra e vendos jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-ën?

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "Sodex Group" shpk - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me instrumente metalprerëse LOT 2 me nr. të prokurimit: 19-111-1-2-1 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosovës sh.a

Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë.

Eksperti shqyrtues në fund pas shqyrtimit të pretendimit të parashtruar në ankesë nga OE ankues konstaton se AK –ja në kundërshtim me nenin 59 LPP-se ka bërë vlerimin e ofertave dhe njëherit nuk është respektuar neni 60 LPP-se – Tenderi I përgjegjshëm me çmim më të ulët sepse Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me pyetje/përgjigje të lartë cekur.

Prandaj eksperti shqyrtues duke u bazuar në sqarimet e dhëna më lartë dhe në pyetjen nr.46 të publikuar në faqe të KRPP-se vlersonte se pretendimi ankimor është i qëndrueshëm për shkeljet shkelqetë dhe dispozitat e LPP-se të cekura në ankese.

Mendimi i ekspertit shqyrtues -Teknik

Andaj, Duke u bazuar në atë që u cekë më lartë eksperti shqyrtues- teknik i propozon panelit shqyrtues që të aprovoj si të bazuar ankesën e operatorit ekonomik ankues “Sodex Group” sh.p.k” – Prishtinë, ndërsa të anulohet vendimi për dënim të kontratës dhe ky aktivitet të kthehet në rivlersim.